



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:245728
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06216469

AC-I-24-0392

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

H T Prizren, i përfaqësuar nga **S S** avokate nga Suhareka.

E paditura

NSH, D.L.B "Lavërtari Blegtori" Prizren(në likuidim), të cilën e përfaqëson,
Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë,
Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1605 të datës 02 maj 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura ankimore sipas ankesës së paditësit të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1605 të datës 02 maj 2024, deri sa të zgjidhet çështja paraprake në lëndën në pritje, C-III-18-0071.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Procedura sipas padisë së paditësve B,D1,D2,S,A,N,Z dhe S N ,J P ,J dhe S B

Me datë 21 tetor 1994, Gjykata Komunale e Prizrenit me Aktgjykimin C.nr.738/91 e kishte anuluar Kontratën e shitblerjes leg. Nr... të satës . shtator .., dhe Kontratën e shitëblerjes nr... të datës . shkurt .., të lidhur në mes paraardhësit të paditësve, B,D1,D2,S,A,N,Z dhe S N ,J P ,J dhe S B nga fshati L Prizren dhe NSH-së se paditur, të cilat kontrata ndërlidhen me ngastrat kadastrale nr. ., .,., . dhe .., ZK Prizren.

Me datë 22 prill 2009, paditësit e cekur kanë dorëzuar një padi në Gjykatën Komunale në Prizren për kthimin e patundshmërive lëndore, duke u bazuar në Aktgjykimin, C.nr.738/91 datë 21 tetor 1994.

Me datë 28 janar 2010, e paditura ka parashtruar ankesë në DHPGJS kundër Aktgjykimit aprovues të padisë, C.nr.283/09 të datës 24 nëntor 2009, të Gjykatës Komunale të Prizrenit. Kjo ankesë është regjistruar në DHPGJS për Kolegjin e Apelit me numrin, AC-II-12-0141.

Me datë 13 prill 2018, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-II-12-0141, ankesën e të paditurës e aprovon si të bazuar, e anulon Aktgjykimin të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.283/2009 të datës 24 nëntor 2009, dhe lëndën e kthen në rigjykim në Kolegjin përkatës të Specializuar të DHPGJS-së. Kolegji i Apelit kishte arsyetuar se Gjykata Komunale në Prizren e ka marrë Aktgjykimin në mungesë të juridiksionit lëndor mbi padinë, andaj ka vendosur ta anuloj Aktgjykimin dhe lëndën ta kthej për rigjykim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim ajo regjistrohet me numrin, C-III-18-0071, dhe është lëndë aktive në shkallën e parë të DHPGJS-së.

Procedura e Likuidimit në bazë të padisë së paditësit H T.

Më date 15 gusht 2014 paditësi H T e ka dorëzuar një kërkesë pronësores lidhur me ngastrën kadastrale P-., tek Autoriteti i Likuidimit, duke kërkuar ti njihet e drejta e pronësisë për këtë ngastër, pasi që këtë ngastër pretendon se e ka blerë nga familja N.

Me datë 21 shtator 2015, Autoriteti i Likuidimit me vendimin PRZ009-0117, kërkesën pronësore të paditësit për ngastrën e cekur e refuzon si të pa vlefshme, në bazë të arsyeve vijuese: Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar ka konstatuar se nuk kishte informata dhe dëshmi të mjaftueshme për ta mbështetur kërkesën pronësore, andaj me datë 24 mars 2015, Autoriteti i likuidimit e ka dërguar një letër për paditësin me të cilin janë kërkuar dëshmi përkatëse për ta mbështetur kërkesën. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se paditësi e ka pranuar letrën me datë 25 mars 2015, mirëpo brenda këtij afati nuk është pranuar ndonjë përgjigje. Andaj në mungesë të përgjigjes Autoriteti i likuidimit ka konstatuar se paditësi H T nuk ka pasur autorizim për përfaqësim, pastaj nuk ka dorëzuar as kontratën leg.nr ..datë .. shkurt .., dhe as dëshmi konkrete se në çfare baze pretendojnë titullin pronësor ndaj ngastrës lëndore. Autoriteti i Likuidimit po ashtu konstaton se nuk ka dëshmi se është anuluar kontrata, nuk ka dorëzuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizreni me të cilin pretendohet se është anuluar kontrata lëndore e shitëblerjes. Autoriteti i Likuidimit konstaton poashtu se paditësi të vetmen dëshmi e kishte dorëzuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 283/09 datë 24 nëntor 2009, mirëpo ky aktgjykim nuk është i formës së prerë, pasi që rezulton se ai është ankimuar në DHPGJS. Andaj në mungesë të dëshmive përkatëse kërkesa për njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën e cekur, ka mbete jo e plotë dhe bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojësës së Ligjit të AKP-së, kërkesa është refuzuar si e pa vlefshme.

Me datë 05 tetor 2015, paditësi H T e dorëzon një ankesë ndaj Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PRZ009-0119 të datës 21 shtator 2015, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga DHPGJS-ja që të vazhdohet të punohet me lëndën e tij

lidhur me kërkesën e njëjte pronësore e evidentuar AC-II-12-0141, e që në fakt ai i referohet lëndes C-III-18-0071, që është aktive në shkallën e parë.

Me datë 07 gusht 2023, paditësi e dorëzon një parashtresë të cilin ai e quan precizimin dhe plotësim të padisë. Në këtë parashtresë ai prape i referohet vendimit refuzues të Autoritetit të Likuidimit. Në këtë parashtresë ai pohon se është pronar faktik i ngastrës P-.. mbi dhjetë vite dhe se i plotëson kushtet që ti njohët e drejta e pronësisë për ngastrën lëndore të padisë.

Me datë 20 shtator 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja i referohet arsyeve ligjore në baze të cilave Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit lidhur me pronën lëndore. Në këtë parashtresë, AKP-ja konsideron se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja konsideron se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa paditësi bazuar në nenin 7 të LPK-së ai nuk ka mundur ta mbështet ,me prova kërkesën e tij pronësore për ngastrën e cekur, megjithëse e kishte barrën e provës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar në këtë parashtresë të refuzohet ankesa si e pa bazuar, dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Bashkë me këtë parashtresë AKP-ja e ka dorëzuar kopjen e kërkesë për dokumentacion shtesë, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe vendimin për emërimin e anëtareve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 04 janar 2024 mbahet një seance dëgjimore lidhur me padinë e cila nuk përfundon dhe shtyhet. Në këtë seancë paditësi i ka ofruar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.283/09 datë 24 .02.2009.

Me datë 29 mars 2024, paditësi e dorëzon edhe një parashtresë në DHPGJS. Në këtë parashtresë ai ka kërkuar që të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, dhe ti njihet e drejta e pronësisë për ngastrën P-., vendi i quajtur "P. A.", me sipërfaqe 2506 m2 ZK Prizren. Bashkë me këtë parashtresë ai ka dorëzuar

një kërkesë që ndërlidhet me lëndën, AC-II-12-0141, Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-II-12-0141 datë 13 prill 2018.

Me datë 26 mars 2024, mbahet edhe një seance dëgjimore mbi padinë. Në bazë të proces verbalit, Kryesuesi i Kolegjit i ka bërë me dije palët se kjo procedure në këtë lëndë është e ndare nga lënda, C-III-18-0071. Në bazë të procesverbalit, përfaqësuesi i paditësit ka mbetur pranë pretendimeve të mëhershme dhe kërkon që paditësit ti njihet e drejta e pronësisë për ngastrën P-.. Ndërsa përfaqësuesi i AKP-së ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, duke u bazuar në arsyet e dhëna nga Autoriteti i Likuidimit.

Me 02 maj 2024, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-1605, e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS ka arsyetuar se paditësi ka kërkuar njohjen e të drejtës se pronësisë për ngastrën kadastrale, P-. në sipërfaqe prej 2506 m² e cila gjendet në vendin e quajtur "P A", ZK Prizren mbi bazën e fitimit të drejtës se pronësisë me parashkrim fitues. Tutej Kolegji i Shkallës së parë i DHPGJS-së konstaton se e paditura në bazë të provave në dosje është pronare e ngastrës, ., pasi që kjo ngastër është në emrin e saj në regjistrin kadastral. Në bazë të Autorizimit të datës 05/12/2008, vërtetohet se B N etj, gjithsejte (11 persona), duke e konsideruar veten si pronarë të pronës kontestuese fillimishtë e kanë autorizuar paditësin H T që të njëjtën pronë ta shesë në emrin dhe llogarinë e tyre. Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se në bazë të Deklaratës të 05 dhjetor 2008 (të cilës i referohet në parashtresën e datës 29 mars 2024), vërtetohet se paditësi H T ka blerë ngastrën P-.. në sipërfaqe prej 2506 m², nga pjesëtarët e familjes N. , dhe se është bërë edhe pagesa e çmimit të blerë, dhe se paluajtshmëria i është dorëzuar në posedim. Tutje Kolegji i shkallës së I-rë po ashtu konstaton se B. N. etj në vitin 2009, kane paraqitur padi për kthimin e ngastrës kontestuese pranë Gjykatës komunale në Prizren. Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin, C.nr.283/09 të datës 24 shkurt 2009, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve B N etj. Mirëpo në bazë të ankesës së AKP-së, ky aktgjykim është anuluar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS, me Aktvendimin, AC-II-

12-0141 të datës 13 prill 2018, dhe lënda është kthyer në rigjykim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, dhe kjo lëndë regjistrohet me numrin, C-III-18-0071 dhe është lëndë aktive. Tutje Kolegji i shkallës së I-ë ka arsyetuar se kërkesëpadia e paditësit, H T është e pa bazuar, pasi që ai nuk mund ta fiton të drejtën e pronësisë për ngastrën lëndore, në bazë të parashkrimit fitues, bazuar në nenin 28.2 dhe 28.4 të Ligjit për marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike të vitit 1980.

Me datë 14 maj 2024, paditësi përmes postes e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1605 të datë 02 maj 2024, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Për me tepë në ankesë paditësi ka pohuar se datë 07.09.2015, e ka dorëzuar një padi ndërhyrëse në lëndën, AC-II-12-0141, në të cilën procedurë Gjykata nuk e ka ftuar asnjëherë. Tutje ai pohon se në këtë lëndë C-IV-15-1605, kemi pasur interes personal dhe juridik të kyçemi, në të cilën lëndë, nuk ishin palë në procedurë, shitësit e ngastrës që është objekt shqyrtimi, duke pohuar se shitësit i kanë marrë paratë për parcelën lëndore. Tutje paditësit pretendojnë se Gjykata e shkallës së I-rë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale dhe të dispozitave materiale, pasi që paditësi H T është dashtë të jetë palë në procedurën që zhvillohet sipas lëndës , AC-II-12-0141 e jo në lenden C-IV-15-1605, sepse në këtë lëndë, nuk janë palë shitësit e ngastrës së cekur të cilën ai është duke shfrytëzuar, jo mbi bazën e parashkrimit siç thirret gjykata e shkallës së I-rë, por e shfrytëzojnë mbi bazën e shitblerjes. Tutje paditësi pohon se në arsyetimin e aktgjyimit nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, ndërsa dispozitivi është në tërësi në kundërshtim me arsyetimin e Aktgjyimit. Tutje paditësi pohon se për interesa të veta personale ka blerë ngastrën P-.. në sipërfaqe prej 2506 m2 ZK Prizren, nga shitësi B N e të tjerë. Ai pohon se nga shitësit fillimisht e ka marrë Autorizim që tua shesë këtë pronë në emër për llogari të tyre, pastaj këtë pronë në vitin 2008 e ka blerë nga shitësit në vlerën 62.500,00 euro, e që vërtetohet me Deklaratën e vërtetuar nga shitësi në Gjykatën Komunale në Pejë. Paditësi pohon se këto prova i ka bashkangjitur si palë ndërhyrëse, në lenden AC-II-12-0141. Tutje ai pohon se B Ne ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të Aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.283/09. Paditësi po ashtu pohon se ka pranuar vendimin

PRZ009-0117 të Autoritetit të Likuidimit, me të cilin i është refuzuar kërkesa si e pa vlefshme. Tutej ai pohon se është posedues i rregullt dhe në mënyre të pa ndërprerë i ngastrës lëndore, ku pohon se ka ndërtuar edhe shtëpi banimi, pas identifikimit të pikave kufitare të ekspertit gjeodet në lëndën C.nr.283/2009. Padiësi në ankesë pretendon se e drejta e tyre pronësore për ngastrën e cekur është shkelur nga ana e Gjykatës, duke mos shqyrtuar fare provat në shkresat e lendes, dhe duke mos vërtetuar saktë gjendjen faktike.

Më datë 04 korrik 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigje në ankesën e padiësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të padiësit duke i konsideruar si të pa bazuar në ligj, dhe mbështet në tersi aktgjykimin e ankimuar duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja në këtë parashtresë pohon se padiësi ka dështuar të paraqesë fakte dhe prova të reja për të vërtetuar një gjendje tjetër faktike, nga ajo që është vërtetuar me Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë. Nga këto arsye AKP-ja k a kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Pezullohet Procedura sipas ankesës së padiësit. Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Ne bazë të nenit 278 par.1 pika a) të LPK-së, Gjykata e ndërprerë procedurën për gjykimin e çështjes nëse ka vendosur që vet mos ta zgjidhë çështjen paraprake. Sipas nenit 13 par.1 të LPK-së kur vendimi i gjykatës varet nga zgjidhja paraprake e çështjes për atë se a ekziston ndonjë e drejtë subjektive apo raport juridik, për të cilën një Gjykatë tjetër ose organ tjetër nuk ka marrë vendim (çështja paraprake) gjykata ka tagër që vet ta zgjidhë çështjen e tillë nëse me dispozita të veçanta nuk caktohet ndryshe.

Kolegji i Apelit vëren se lidhur me objektin lëndor të padisë, ngastrën P-..është një lëndë tjetër në pritje e evidentuar C-III-18-0071, rezultati i së cilës ka ndikim esencial në rezultatin që do të jepet në lëndën AC-I-24-0392 (C-IV-15-1605). Nga pohimet e paditësit vërehet se ai ka pohuar se është paraqitur si ndërhyrës në lëndën tjetër në pritje C-III-18-0071.

Rezultati që do të jepet në lëndën C-III-18-0071 ka ndikim edhe lidhur me të drejtën e pretenduar pronësore të paditësit H T në këtë lëndë.

Prandaj Kolegji i Apelit ka vlerësuar që në këtë rast, është e nevojshme të pezullohet procedura sipas ankesës së paditësit të paraqitur ndaj Aktgjyqimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-1605 të datës 2 maj 2024, dhe atë deri sa të vendoset në merita me një vendim gjyqësor të formës së prerë çështja kontestuese në lëndën tjetër në pritje C-III-18-0071.

Pasi të zgjidhet çështja kontestuese në lëndën C-III-18-0071 me një vendim të formës së prerë, secila palë në lëndën AC-I-24-0392, me një parashtresë mund të kërkoj nga Kolegji i Apelit heqjen e pezullimit dhe vazhdimin e procedurës ankimore sipas ankesës së paditësit të paraqitur ndaj Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJ-së C-IV-15-1605 të datës 2 maj 2024.

Nga sa u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 26 shtator 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____